



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.1015/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Dr.sc. Rafet Haxhaj kryetar dhe Milena Gjeriq e Valon Totaj anëtarë, me zyrtaren ligjore Fitore Isufi-Saraçi, në çështjen juridike të paditësit SH.I. nga fshati ..., Komuna Viti, të cilin e përfaqëson V.M. avokat në Ferizaj, Rr. "...", kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit, Rr."Lidhja e Pejës" pn, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Olumbie Haliti nga Prishtina, baza juridike kompensim dëmi, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega Kaçanik, C.nr.275/17 të datës 23.09.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 29.07.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me miratimin e pjesërishtë të ankesës së të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Prishtinë, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega Kaçanik, C.nr.275/17 të datës 23.09.2019, në pjesën sa i përket kompensimit për dhembje fizike, për frikë, për shëmtim trupor dhe zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, për paditësin SH.I., dhe gjykohet:

DETYROHET e paditura Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Prishtinë, që paditësit SH.I. për dhembje fizike, t'ia kompensoj shumën 3,500.00€, për frikën e pësuar, shumën 3,000.00€, për shëmtim trupor, shumën 1,000.00€ dhe për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, t'ia kompensojë shumën prej nga 4,800.00€, pjesa e kërkesëpadisë për këto kategori të dëmit mbi shumat e gjykuara dhe pjesa e kërkesëpadisë sa i përket rehabilitimit klimaterik refuzohet, si e pa bazuar, ndërsa sa i përket pjesës tjetër të dispozitivit të aktgjykimit, që ka të bëjë me ndihmën e personit tjetër, ushqimin e përforcuar dhe shpenzimet e shërimit, ankesa e të paditurës REFUZOHET si e pa bazuar dhe aktgjykimi i atakuar me ankesë në këtë pjesë VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në pikën I., të dispozitivit miratohet pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit SH.I. nga fshati ... Komuna Viti dhe detyrohet

e paditura Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë Rr. "Lidhja e Pejës" pn, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material, të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 05.07.2017, t'ia paguaj: për dhembje trupore-fizike, shumën 7,000.00€, për frikën e shkaktuar, shumën prej 4,900.00€, për zvogëlimin e aktivitetit jetësor, shumën prej 7,000.00€, për shëmtim trupor, shumën prej 4,000.00€, për ndihmën dhe kujdesin e personit të tretë, shumën 200.00€, për rehabilitim klimaterik, shumën 300.00€, për ushqim të përforcuar, shumën 200.00€, për shpenzimet materiale gjatë kohës së shërimit, shumën 208.27€, gjithsej 23,808.27€. në pikën II., të dispozitivit refuzohet pjesa tjetër e kërkesëpadisë mbi shumat e miratuara në lartësi 3,250.00€. Të gjitha këto shuma me kamatë vjetore prej 8% duke filluar prej datës 13.11.2017 dita e ushtrimit të padisë e gjerë në pagesën definitive. në pikën III., të dispozitivit detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguaj shumat e gjykuara në pikën I të dispozitivit, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë 1,422.20€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit në dorëzim, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur e paditura, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës anesën ta aprovojë dhe të prishë aktgjykimin e shkallës së parë dhe shumat e gjykuara ti gjykojë dukshëm më të ulëta, duke pasur parasysh të gjitha pretendimet ankimore apo çështja të kthehet në rigjykim dhe të eliminohen vërejtjet e sipërshënuara.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar paditësi.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit:

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi SH.I. ka parashtruar padi ndaj të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit t'ia kompensoj dëmin: për dhembje fizike shumën 13,350.00€, për frikën e pësuar, shumën 4,700.00€, për zvogëlimin e aktivitetit jetësor në shkallë 17%, shumën 10,000.00€, për shëmtim shkallë e lehtë, shumën 3,500.00€, për kujdesin e personit të tretë, shumën 200.00€, për ushqim të përforcuar, shumën 200.00€, për rehabilitim klimaterik, shumën 300.00€, shpenzimet e shërimit, shumën 208.27€, gjithsej shumën 27,058.27€. të gjitha me kamatë ligjore 8% nga dita e ngritjes së padisë.

Gjykata e shkallës së parë ka administruar provat si: raporti i aksidentit i datës 05.07.2017, raporti i policit hetues i datës 05.07.2017, raporti mjekësor nga shtëpia e shëndetit Viti i datës 05.07.2017, raporti nga Spitali i Përgjithshëm në Gjilan i datës 06.07.2017, fletlëshimi nga QKUK-ja Prishtinë i datës 31.07.2017, fletlëshimi nga QKUK-ja-Klinika e Kirurgjisë Torakale me nr.5249, raportet mjekësore, kuponët fiskal, aktakuza PP.II/ nr.1404-6/17, aktgjykimi nga Gjykata Themelore në Ferizaj-Dega Kaçanik P.nr.6200/17, si dhe ekspertiza mjekësore e ekspertëve të caktuar nga Gjykata e datës 22.08.2019.

Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar gjendjen faktike: se aksidenti i komunikacionit ka ndodhur me datë 05.07.2017 në fshatin Leskovic Viti, ky aksident është shkaktuar me fajin e vozitësit të automjetit Kombi LT me targa 06-566-BL i cili në momentin e aksidentit ishte pa mbulesë siguruese, me ç'rast lëndime të rënda trupore ka pësuar paditësi SH.I., si rezultat i këtyre lëndimeve paditësi ka pësuar dhimbje fizike dhe frikë, ka pasur zvogëlim të aktivitetit jetësor në shkallë prej 17%, ka pësuar shëmtim në shkallë të lehtë, ka pasur nevojë për ndihmën e personit të tretë dhe ka pasur nevojë për rehabilitim klimaterik, ushqim të përforcuar si dhe shpenzime gjatë shërimit. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar me ankesë.

Baza ligjore:

Neni 194 i LPK-së: "Gjykata e ankimit ekzaminon aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k), dhe m) të këtij ligji".

Neni 195.1 i LPK-së: "Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj:d) ta refuzojë ankesën si të pa themeltë dhe ta vërtetojë aktgjykimin e goditur".

Neni 195.1 i LPK-së: "Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj:e) ta ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë".

Neni 319.1 i LPK-së: "Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi te cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta"

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit:

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, lidhur me ankesën e parashtruar nga e paditura ka gjetur se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore. Lidhur me gjendjen faktike, gjykata e shkallës së dytë vlerëson se e njëjta është vërtetuar në mënyrë të drejtë në pjesën më të madhe të kërkesave të parashtruara. Kolegji i gjykatës së shkallës së dytë, gjen se në pjesën e kërkesëpadisë që ka të bëjë me rehabilitimin klimaterik, në këtë pjesë nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike sepse në shkresat e lëndës nuk ka prova që dokumentojnë dhe argumentojnë shpenzimet e krijuara për këtë kategori të shpërblimit të dëmit.

Lidhur me aplikimin e të drejtës materiale, gjykata e shkallës së dytë ka gjetur se, mbi një gjendje të vërtetuar faktike në mënyrën siç u theksua si më lartë, e drejta materiale në pjesën e dispozitivit që është ndryshuar, është aplikuar në mënyrë të gabuar dhe se qëndrojnë pretendimet ankimore të palës së paditur për këtë pjesë të dispozitivit. Kjo për faktin se, nga ana e gjykatës së shkallës së parë në radhë të parë është miratuar pjesa e kërkesëpadisë për shpërblimin e dëmit për rehabilitim klimaterik për paditësin SH.I., ndërsa sa i përket pjesës së miratuar të kërkesë padisë, për dhembje fizike, për frikën e pësuar, për shëmtim trupor dhe për zvogëlimin e aktivitetit jetësor kolegji vlerëson se shumata e gjykuara nuk janë në përputhje të plotë me nenin 183.2 të LMD-së dhe me praktiken gjyqësore tashmë të ndërtuar për rastet e tilla. Kolegji nuk e ka miratuar mënyrën e të vendosurit të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me rehabilitimin klimatik, pasi ka vlerësuar se, kërkesa lidhur me shpenzimet e këtij shërbimi paraqet dëm material dhe meqenëse paraqet një dëm të tillë, ajo duhet që të dokumentohet me prova, përkatësisht faturat e pagesës dhe dokumentacionin tjetër përcjellës të cilat do të dëshmonin lidhur me qëndrimin e paditësit në institucionin rehabilitues dhe shfrytëzimin e shërbimeve të rehabilitimit. Për këtë arsye, kolegji duke u bazuar në dispozitat e sipërcituara të LMD-së dhe nenit 195 pika e) të LPK-së, ka miratuar pretendimet ankimore të të paditurës, ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë në këtë pjesë dhe ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit sa i përket kërkesës lidhur me rehabilitimin ligjor.

Në nenin 183.2 të LMD-së, është parashikuar që: *“Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me të mos favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”*. Kolegji me këtë rast ka pasur parasysh rastin që është paraqitur për zhdëmtim dhe ka gjetur se gjykata e shkallës së parë ka caktuar shuma shumë më të larta se sa vendosin gjykatat në rastet e tilla. Për këtë shkak, kolegji i gjykatës së shkallës së dytë, duke u bazuar edhe në nenin 195 par 1, pika e) të LPK-së, ka bërë ndryshimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë edhe sa i përket caktimit të

shumës për dhembje fizike, për frikën e pësuar, për shëmtim trupor dhe për zvogëlimin e aktivitetit jetësor duke vendosur më tutje si në dispozitivin e këtij aktgjykimi. Kolegji vlerëson se, shumat e caktuara si në dispozitivin e këtij aktgjykimi janë në përputhje të plotë me të mirën e cenuar dhe janë në përputhje me nenin 183.2 të LMD-së, dhe praktikën gjyqësore për rastet me lëndimet e rënda: për dhembje fizike caktohen deri në 3,500.00€, për frikën e pësuar caktohen deri në 3,000.00€, për shëmtim trupor, caktohen 1,000.00€ dhe për zvogëlimin e aktivitetit jetësor për shkallën 17% shumat caktohen deri në 4,800.00

Lidhur me pretendimet e palës së paditur që kanë të bëjnë me pjesën e dispozitivit sa i përket ndihmës së personit të tretë, ushqimit të përforcuar dhe shpenzimeve të shërimit, kolegji këto pretendime i ka refuzuar si të pa bazuara, pasi nga ekspertimi i ekspertëve mjekësor ka rezultuar që paditësi ka pasur nevojë për ndihmën e personit të tretë për 21 ditë dhe për ushqim të përforcuar po ashtu për 21 ditë. Duke u mbështetur në nenin 323 të LPK-së dhe praktikën gjyqësore për rastet e tilla për një ditë caktohet shuma prej 10,00 €, kolegji gjenë se shumat e gjykuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, në këtë pjesë, janë në përputhje të plotë me nenin 183.2, nenin 323 dhe praktikën gjyqësore që zhvillojnë gjykata në Kosovë, në rastet e tilla. Ndërsa sa përket shpenzimeve të shërimit, kolegji gjenë se në shkresat e lëndës dhe në procedurën e provave janë administruar kuponët fiskal, të cilët dokumentojnë shpenzimet e bëra me rastin e mjekimit të paditësit. Për këto shkaqe, kolegji i ka refuzuar pretendimet ankimore të të paditurës dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, në këtë pjesë të dispozitivit të vendimit gjyqësor.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e pajtim me dispozitat e nenit 195 par.1, pika e) dhe d) të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.1015/20 me datë 29.07.2021

Kryetari i kolegjit- gjykatësi,
Dr.sc. Rafet Haxhaj, d.v